



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE  
KESHILLI BASHKIAK

Nr 952/11 Prot

B.Curri, me 07 . 03 . 2022

V E N D I M

Nr 19 Dt . 28.02. 2022

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË TROPOJË, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. VLADIMIR QAZIM MARGJEKA BANOR I FSHATIT **MOLLË E KUQE**, NJESIA ADMINISTRATIVE BUJAN, BASHKIA TROPOJE PËR DJEGJEN E BANESËS DATË 07.02.2022

Këshilli i Bashkisë Tropojë, në mbledhjen e tij të datës **28.02. 2022**, në mbështetje të nenit 8 pika2, nenit 9 pika1/1.1, shkronja “b”, nenit 34 pika 6, nenit 54 shkronja “dh” dhe nenit 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 45/2019, “Per Mbrojtjen Civile”, Kreu III, pika 1 germa “ë”, pika 2, pika 3 gërmat “ç”, “e”, “ë” të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmëve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Sipas kërkeses te bërë nga pronari i këtijë objekti datë **08. 02. 2022**, njekohësisht duke pare gjëndjen e rënduar ekonomike të kësaj familje, për ti përballuar këto dëmtime të djegjes së **Banesës**.

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tropojë për përgaditjen e dokumentacionit për dhënje ndihme financiare familjes se Z , Vladimir Qazim Margjeka, si pasoje e djegjes së **Baneses** datë **07.02.2022** .

2 . Familjes se Z , Vladimir Qazim Margjeka, ti jepet një ndihmë e menjëhershme leke **50 000** ( pesëdhjetë mijë ).

3. Vlera sipas VKM-së nr. 329 Kreu III, pika 3 gërma "b" dhe "d" është **271 083 leke**, (dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e tre). Për shkak të pamundësisë së financimit nga Bashkia Tropoje, për të mbuluar të gjithë vleren në lekë i jepet shuma **50 000** (pesëdhjetë mijë ) lekë.

Në një moment të dytë, pasi të sigurohet fondit do të bëhet likuidimi i plotë i pjesës së mbetur **221 083**

4. Burimi i financimit është Fondi Emergjences Civile të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tropojë për vitin 2022 miratuar me VKB , Nr.111 datë 24.12.2021, "Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2022 njëqind mijë."

5. Të miratojë dokumentacionin tekniko- ligjor të hartuar nga Bashkia Tropojë

6. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Finances.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretar**  
Ergent GJONGECAJ

Shpallur me 07.03.2022  
Miratuar me 15 vota  
Vota Pro 15  
Vota Kunder 0  
Vota Abstenim 0

**Kryetar**  
Shotë BASHAJ

